



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfituesve”
2. Seancë dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit për prezantimin e ecurisë së procesit për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Robert Bitri, Artan Gaçi, Esmeralda Shkja, Fatmir Toçi, Artur Bushi, Besnik Baraj, Piro Kapurani, Ervin Koçi, Namik Kopliku, Gentian Bejko, Rakip Suli, Bujar Derveni, Vladimir Kosta, Ervin Buashti, Dashamir Kamberi, Erjeta Alhysa dhe Blerina Gjylameti.

Mungojnë:

Genc Ruli, Sherefedin Shehu, Ardian Turku, Agron Duka, Besnik Dushaj, Voltana Ademi, Gjergji Papa, Helidon Bushati, Kozma Dashi, Dashamir Tahiri, Parid Cara, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi dhe Monika Kryemadhi.

Të ftuar:

Majlinda Bogo - këshilltare në Ministrinë e Bujqësisë.

Irfan Tarelli- drejtor i Administrimit të Ujit dhe Tokave.

Evelina Çela- këshilltare për marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë e Bujqësisë.

Alfred Dalipi – zëvendësministër në Ministrinë e Turizmit.

Sonja Popa- drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Turizmit.

Alba Canaj- specialiste në drejtorinë e Zhvillimit Urban.

Albana Koçollari- specialiste në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëdita, të gjithëve!

Sot në rendin e ditës së komisionit kemi dy çështje:

Projektligjin “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”;

Seancë dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit për prezantimin e ecurisë së procesit për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin.

Kemi të ftuar përfaqësues të Ministrisë së Turizmit në lidhje me një draft që ata kanë përgatitur për zonat turistike të mbrojtura në Shqipëri.

Gjithsesi, pjesa e dytë është një prezantim i ministrisë. Unë u vura në dijeni me këtë draft që ata kishin përgatitur dhe gjykova se do të ishte mirë që komisioni, dhe publiku nëpërmjet komisionit, të ishte pjesë e një seance dëgjimore.

Ka ndonjë vërejtje për këto pika? Nuk ka.

Ne nuk jemi komision përgjegjës, por jemi për dhënie mendimi për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve.

Në fakt, është një çështje që ne e kemi diskutuar edhe kohë më parë, por donim të dëgjonim edhe shpjegimin e përfaqësuesve të ministrisë.

Zoti Bitri, është relator.

Zoti Bitri, urdhëroni!

Robert Bitri – Ideja e këtij projektligji është për përfundimin e procesit të ndarjes së tokës, i cili pavarësisht se është kryer në praktikë, nuk janë mbyllur procedurat ligjore të plotësimit dhe dokumentacionit, dhe nuk është përfunduar i gjithë procesi, pra, te marrja e titujve të pronësisë nga të gjithë poseduesit e tokës bujqësore.

Në logjikën e projektligjit, në saktësimin e saj, unë dua të qartësoj dy momente që mendoj se janë të diskutueshme:

Problemi i parë është afati i përfundimit të këtij procesi, i cili ka një datë, që është 31 dhjetori i vitit 2015, por unë gjykoj se ky proces nuk do të arrijë të mbyllet, sepse jemi në fundin

e mandatit të të gjitha institucioneve të pushtetit vendor, të cilat vitin tjetër, në qershor, ato duhet ta mbyllin dhe rregullsia, shpejtësia dhe gjithë puna e tyre nuk do të jetë në atë rendiment sa të realizojnë këtë afat më 31 dhjetor 2015.

Për hir të së vërtetës, unë e gjykoj që duhet të shtohet, por zotërinjtë e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Këshillit të Ministrave mendojnë se ky afat quhet i përfunduar si proces i dokumentacionit, kurse marrja e titujve të pronësisë mund të vazhdojë edhe më tej, ose me një shtesë tjetër, sepse projektligji 55/ 2012, nuk arriti dot të mbyllte procesin. Me përfundimin e tij dhe duke mos lejuar mundësitë për shtimin e afatit ligjor, këta mendojnë që ky projektligj duhet bërë, që edhe nëse nuk përfundon deri në datën 31 dhjetor të vitit 2015, ne të shtojmë afatin.

Kështu që në këtë moment, mendoj se zotërinjtë e ministrisë të na thonë se si e shikojnë ata në këndvështrimin e qeverisë këtë afat dhe për mbylljen e këtij procesi për ndarjen e tokave bujqësore të fermerit me pajisjen e titujve të pronësisë.

Eduard Shalsi – Dakord.

Ky është ligj i ri?

Robert Bitri – Jo. Ky është një ligj, po e quajmë të ri, por është në vazhdim të të gjithë procesit të ndarjes së tokave nga viti 1991 deri më sot.

Projektligji i fundit i mbyllte në datën 13 prill 2014 dhe kjo gjë e lë të hapur si proces, sepse sot kemi disa kategori: kemi njerëz që kanë marrë aktin e pronësisë, ose që nuk janë pajisur me aktin, por kanë marrë vetëm aktin e tokës në përdorim; kemi njerëz që kanë marrë aktin e tokës në përdorim dhe aktin e tokës në pronësi, por nuk e kanë regjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të pajisen me certifikatë; kemi një kategori tjetër të njerëzve, të cilët pavarësisht se kanë marrë aktin e përdorimit dhe aktin e pronësisë, nuk janë bërë ende pronarë të kësaj toke.

Kështu që i gjithë ky proces pretendon që më 31 dhjetor 2015 të mos ketë asnjëri që të mos ketë mbyllur dokumentacionin për të marrë aktin e pronësisë dhe të paraqitet në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të marrë aktin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

Eduard Shalsi – Dakord.

Faleminderit!

Nga ministria në mënyrë sa më koncize të mundshme duam të dimë çfarë ka synuar ky ligj, sepse bëhet fjalë për një ligj që është shfuqizuar më 1 tetor 2013 dhe meqenëse nuk shtyhej dot afati i atij ligji, është sjellë një ligj i ri, mot a mot, do ta thoni ju. Duam një shpjegim shumë konciz për komisionin dhe për publikun: çfarë synohet? Si kërkohet të arrihet ajo që synohet?

Të ftuar kemi: Irfan Tarelli, drejtor i administrimit të ujërave dhe tokës në Ministrinë e Bujqësisë; Majlinda Bogo, këshilltare në Ministrinë e Bujqësisë; Evelina Çela, këshilltare në Ministrinë e Bujqësisë.

Zoti Tarelli, urdhëroni!

Irfan Tarelli – Ky projektligj që sillet sot për shqyrtim dhe miratim niset nga nevoja për formalizimin e marrëdhënieve që kanë fermerët e caktuar, punonjës të ish- NB-ve, të cilët kanë qenë subjekte të ligjit, por për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive deri në momentin aktual nuk është bërë e mundur pajisja e tyre me aktet e marrjes së tokës në pronësi. Në fakt, trajtimi i këtij problemi është bërë edhe nëpërmjet një ligji të mëparshëm, të ligjit nr. 5712, i cili përcaktoi procedurat për plotësimin e akteve të marrjes në pronësi dhe vuri si afat të përfundimit të tij, duke e cilësuar në një nen të veçantë, që bie nga fuqia, më 1 tetor të vitit 2013 për arsye që janë shpjeguar edhe në relacion.

Së pari, neglizhencë e organeve të njësive të qeverisjes vendore;

Së dyti, për kohën e gjatë që ka marrë korrespondenca e konfirmimit të këtyre akteve nga disa institucione që përcakton ligji, shtuar dhe faktin që ka qenë një vit elektorale nuk u bë e mundur që procesi të përfundojë dhe të arrijë qëllimin për të cilin ai ishte miratuar.

Gjithsesi, duhet përmendur fakti se në një pjesë të territoreve të ish- NB-ve njësitë e qeverisjes vendore kanë vepruar dhe e kanë plotësuar në një masë të konsiderueshme ose të pjesshme këtë fenomen dhe ka një numër aktesh të plotësuar. Pra, ligji i mëparshëm e ka arritur objektivin e vet në një masë të caktuar, por ka edhe njësi të qeverisjes vendore që procesi nuk ka konfirmim zyrtar që ka filluar.

Në këto kushte nuk u realizua shtyrja e afatit të ligjit në kohë për ta bërë efektiv dhe në këto kushte edhe në konsultim me ministrinë e tjera, sidomos me Ministrinë e Drejtësisë, u sugjerua risjellja për miratimin e një ligji që ka vetëm ndryshime të vogla në krahasim me ligjin, që ka qenë në fuqi deri në tetor të vitit 2013.

Cilat janë ndryshimet?

Së pari, ka një ndryshim të një fondi toke që ka qenë në dispozicion të Agjencisë së Kthimit të Pronave, e cila i kaloi Ministrisë së Bujqësisë dhe kjo është reflektuar në nenin 3 të ligjit, duke bërë shtesën përkatëse për të lehtësuar evitimin e gabimeve në zbatim.

Së dyti, fiksohet një afat i ri për plotësimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi që është 31 dhjetor 2015.

Së treti, njësitë e qeverisjes vendore, siç i përmenda më lartë, kanë filluar procesin dhe në ndonjë rast kanë dalë edhe përtej afateve ligjore në plotësimin e dokumentacionit.

Në projektligj ka një nen të veçantë që kërkon t'i quajë këto akte të plotësuara të vlefshme me kushtin që të jenë të zbatuara kriteret ligjore të ligjit nr. 5712 dhe të këtij projektligji, i cili në fakt nuk ka ndryshim nga kriteret dhe procedurat. Kjo bëhet me argumentin që të mos fillojë një proces i ri, por të fitohet kohë në atë dokumentacion, që vlerësohet i përputhur me ligjin.

Për sa i përket afatit, argumentet e plotësimit të akteve të marrjes në pronësi brenda një periudhe 1 –vjeçare, ne mendojmë se, së parim është një kohë e mjaftueshme që njësitë e qeverisjes vendore të arrijnë ta realizojnë procesin.

E dyta, diktohet nga nevoja e formalizimit sa më shpejtë të jetë e mundur e këtyre fermerëve, sepse kushtëzon procese të tjera që janë në vijim, siç është: regjistrimi fillestar dhe aq më tepër marrja e certifikatës në pronësisë e bën këtë kategori të mundur të aplikojnë për subvencione, të formalizohen dhe për efekte të tjera.

Gjithsesi, shqetësimi që ngriti zoti Bitri është i drejtë, por ne mendojmë se një afat i tillë është i mjaftueshëm për t'u realizuar.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka pyetje?

Zoti Bushati, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Mendoj se jemi në drejtimin e duhur për një stabilizim një herë e mirë të problemit të tokës, që është kapitali kryesor në bujqësi. Ka qenë në strategjinë tonë të përbashkët sistemimi një herë e mirë, i këtij problemi, duke ditur edhe fragmentimin që ka toka në bujqësi dhe çfarë problemesh sjell kjo. Të gjitha përpjekjet tona kanë qenë të bashkimit të kapitaleve të ndryshme që të arrihet një sens ekonomik në zhvillimin bujqësor.

A po zbatohet një strategji më komplekse, më e përgjithshme që të bashkohen të gjitha tokat ose të kemi një kadastër të tokave bujqësore, siç ka qenë edhe një strategji, nisur më parë, që të mblidhen një herë e mirë, dhe të ketë një hipotekë apo një kadastër të veçantë, ku të administrohen dhe të kemi një përafrim sa më të madh të këtij kapitali që do t'i duhej bujqësisë për ta kthyer në një kapital të vërtetë ekonomik dhe të funksiononte si në të gjithë botën?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Gaçi, urdhëroni!

Artan Gaçi – Në vazhdim të pyetjes së kolegut Bushati ku toka është aseti kryesor i Ministrisë së Bujqësisë, një fenomen tjetër në Shqipëri është ai i tokave të zëna. Është një numër i madh hektarësh toke bujqësore, që aktualisht mund të rezultojnë në arkiv direktivat e Ministrisë së Bujqësisë si toka shtetërore për t'u vënë në funksion të investimeve, por në realitet ato janë të zëna nga çfarëdolloj personash, pa asnjë lloj dokumenti. A ka ndonjë strategji për t'i zhbllokuar këto toka, për t'i kthyer edhe *de facto* pronë e Ministrisë të Bujqësisë në funksion të investimeve?

Eduard Shalsi – Zoti Koçi!

Ervin Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një proces, i cili për vite me radhë ka dështuar, nuk e kanë realizuar misionin edhe ligjet e miratuara dhe pyetja ime ka lidhje me këtë proces. A ka bërë ndonjë analizë të detajuar Ministria e Bujqësisë që ky proces të mos dështojë përsëri?

Eduard Shalsi – Zoti Kamberi e ka fjalën!

Dashamir Kamberi – Duke ju falënderuar për sqarimet që na dhatë, unë do të dëshiroja të bëja një pyetje. Sa është e gjithë sipërfaqja objekt i këtij ligji dhe sa është numri i përfituesve në mënyrë që edhe ne të kemi mundësi të arrijmë në një përfundim edhe për afatin kur do të zbatohet ky ligj?

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Pyetja e zotit Kamberi është një pyetje shumë e saktë, në fakt, po arritëm ta gjejmë ndonjëherë atë.

Zonja Alhysa!

Erieta Alhysa – Faleminderit!

Po në vazhdimin e pyetjes së zotit Gaçi, përveç këtyre sipërfaqeve të tokave që janë shtet dhe që janë të zaptuara, ka edhe sipërfaqe toke shtet në komuna të ndryshme, të cilat janë parë me ligjin nr. 7501, të cilën e përfitojnë fshatarët dhe në momentin që ata aplikojnë për të marrë certifikatën e pronësisë, kjo sipërfaqe toke del shtet. Si do të veprohet me këtë kategori njerëzish?

Pyetja e dytë lidhet me atë çfarë ju thashë më parë. Kemi probleme në disa fshatra të AMTP-së, pra të aktit të marrjes së tokës në pronësi, ku ka mungesa si të firmës së komisionit, të kryefamiljarit apo edhe vulat e thata të këtyre AMTP-ve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Alhysa!

Fjalën e ka zonja Shkjau!

Esmeralda Shkjau – Në lidhje me personat, të cilët nuk kanë plotësuar dokumentacionin e duhur të kësaj toke, si do të procedohet dhe në cilat zona, duke iu bashkëngjitur pyetjes së zotit Kamberi, në cilat zona të Shqipërisë janë këto toka?

Eduard Shalsi - Faleminderit, zonja Shkjau!

Zoti Kosta, deklarata që ju bëtë pa mikrofon me sipërfaqen 650 mijë hektarë është për t'u harruar.

Vladimir Kosta – Faleminderit, zoti kryetar!

Si do të procedohet për tokat shtet në të ardhmen?

Eduard Shalsi – Në qoftë se kolegët i ezauruan pyetjet, edhe unë kam një pyetje. Ligji ka skaduar më 1 tetor të vitit 2013 dhe pse vjen në dhjetor të vitit 2014, ndërkohë që... Pse ky ç'fazim në kohë?

Fjala për ju zoti Tarelli!

Ju lutem citoni edhe emrin e deputetit, të cilit do t'i përgjigjeni.

Irfan Tarelli – Pyetja e parë për mendimin tonë është një nga pyetjet bazale dhe një nga shqetësimet kryesore që ne si ministri kemi në nënkuptimin e miradministrimit....

Eduard Shalsi – Më falni të sqaroj diçka. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe bie nga fuqia jo në prill, por bie nga fuqia më 1 tetor të vitit 2013.

Irfan Tarelli – Për sa i takon pyetjes së parë, mendoj se është një nga shqetësimet kryesore, një nga problemet bazale që ka struktura e bujqësisë sonë për shkak se veprimi i

efekteve të ligjit nr. 7501 dhe i akteve të tjera nënligjore për zbatimin e tij kanë krijuar një fermë shumë të vogël, pra numër shumë të madh fermash, fermë me madhësi shumë të vogël dhe çfarë është më specifike është fragmentimi i saj. Në shkallë vendi ne kemi 3,8 parcela për fermë, ndërsa rastet ekstreme shkojnë deri në 7 parcela për fermë, e cila e bën të vështirë mekanizimin, kimizimin dhe një sërë ndërhyrjesh të tjera, që, në fund të fundit, shkojnë te rentabiliteti i ulët i fermës.

Natyrisht që kjo është një sfidë jashtëzakonisht e vështirë dhe adresimi i saj me instrumente të politikbërjes dhe iniciativave, pritet që efekti i tyre të jetë më afatgjatë. Hapi i parë që ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë nëpërmjet një programi të informacionit bujqësor mbi tokën është evidentimi rast pas rasti jo vetëm i sipërfaqes së tokës bujqësore për çdo individ, por plotësimi i saj edhe me të dhëna të karakterit agronomik, ekonomik etj. Deri tani ne e kemi përfunduar këtë proces pothuajse në 200 mijë hektarë nga 650 mijë hektarë që është toka bujqësore në shkallë vendi.

Hapi i dytë. Është përgatitur një strategji për konsolidimin e tokës bujqësore mbi bazën e modeleve që aplikohen prej vitesh në Europë, por edhe 10-vjeçarin e fundit në rajon, që synon, së pari, minimizimin e fragmentimit dhe çështja kryesore është shkëmbimi i parcelave nëpërmjet fermerëve. Kjo do të thotë që nga 3,8 parcela për fermë, të arrijmë të minimizojmë ose të përgjysmojmë numrin e tyre dhe kjo jodomosdoshmërisht kjo çon në rritjen e madhësisë së fermës, por çon në konsolidimin e saj dhe krijon premisa për një treg më të mirë toke.

Ky projektligj që vjen në mënyrë indirekte kontribuon në procesin e konsolidimit të fermës, sepse kushti i parë që të kalosh në konsolidim është pronësia e qartë, dokumentimi i qartë dhe pastaj nëpërmjet programit të kalohet në projekte specifike të konsolidimit të tokës.

Mënyra e dytë për të adresuar këtë problem është konsolidimi i kulturave, pra nuk ka rëndësi pronësia, por shfrytëzimi mbi bazën e një orientimi nga Ministria e Bujqësisë dhe rajonizimi i kulturave dhe aspekte të tjera ku format e kooperimit shkojnë në të njëjtin drejtim, por me instrumente të tjera.

Nuk e di sa i qartë isha për përgjigjen që ju dhashë, zoti deputet.

(Diskutime pa mikrofon)

Robert Bitri - Projektligji është për të përfunduar regjistrimin edhe për të saktësuar pronën dhe pronarin, pastaj vazhdojmë me pjesën e dytë, e cila ka të bëjë me zhvillimin e bujqësisë.

Irfan Tarelli - Për sa i takon kadastrës multifunkionale, ne si ministri me anë të një programi modest, të cilin po e realizojmë me buxhetin e shtetit, por të integruar edhe me një sistem tjetër në kuadrin e një projekti që financohet nga qeveria italiane, jemi në proces. E quajmë kadastrë të shumëqëllimshme, e quajmë sistemi i informacionit mbi tokën bujqësore dhe kjo është çështje terminologjie. Po punojmë në disa rrethe të vendit paralelisht për të pasur këtë instrument në dorë, e cila është një hartë dixhitale, një database dhe që lehtëson përdorimin e saj jo vetëm nga Ministria e Bujqësisë, por nga të gjithë operatorët, nga të gjithë të interesuarit që merren me tokën bujqësore.

Natyrisht këtu do të integrohet edhe me një program tjetër që ka qeveria në vijim për realizimin e një kadastre jo vetëm të tokës bujqësore, por edhe të kategorisë së resurseve të tjera. Këto janë operacione të kushtueshme, por që kërkojnë edhe kohën e vet për t'u realizuar.

Deri tani ka përfunduar sistemi i informacionit mbi tokën në 200 mijë hektarë tokë, flas për tokën në përgjithësi nga të cilat rreth 100 mijë hektarë nga dhjetori i këtij viti janë tokë bujqësore, të cilat përfshijnë 7 rrethe të vendit kryesisht në zonat më intensive. Kjo pengohet edhe për arsye të tjera që ua thashë, kur regjistrimi fillestar nuk ka përfunduar dhe ne kemi përfundimin e regjistrimit fillestar në 85-86% të zonave kadastrale dhe rurale të vendit, ku edhe me proceset si ky i sotmi me këtë ligj pronësia ende nuk është e qartë, pra toka është në përdorim të subjekteve private, por nuk është e dokumentuar. Ne mendojmë që për dy-tre vjetët e ardhshëm zonën intensive të vendit ta kalojmë nëpërmjet këtij sistemi.

Për sa i përket pyetjes tjetër në lidhje me tokat e zëna, Ministria e Bujqësisë ka evidentuar dhe është në proces evidentimi të këtij fenomeni, por duhet të bëjmë një dallim. Duke iu referuar kuadrin ligjor ekzistues, kemi toka disponibël shtetërore dhe me vendimet e fundit të qeverisë i kanë kaluar Ministrisë së Bujqësisë, është evidentuar e gjithë sipërfaqja dhe po kalojnë në proces qiradhënieje. Kategoria e tokave të pavarura, që është në administrim të pushtetit vendor dhe me një vendim qeverie një fond prej rreth 25 mijë hektarësh i ka kaluar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Nga ky fond, gjithashtu, rezultojnë të dhëna me qira rreth 2400 hektarë, ndërsa pjesa tjetër është disponibël për t'u dhënë me qira dhe këtu përfshihen edhe

kategori ku individë të caktuar kanë zaptuar tokën, ku zaptim do të thotë përdorim për qëllime private, por në mënyrë informale dhe nga ana jonë është kërkuar me forcë, duke kërkuar vendimin e prefektit dhe të qarqeve, që të bëhen të gjitha denoncimet e rastit.

Shumë shpejt mendohet të dilet me një paketë, për të rishikuar edhe një herë mënyrën e administrimit të këtij fondi toke nga pushteti vendor, e cila do të lidhet ...

Nuk ka të dhëna të plota, të evidentuara, por shqetësimet që vijnë rasti pas rasti janë adresuar te këshillat e qarqeve dhe prefektët. Gjithsesi, për të shmangur veprimet abuzive, ka një vendim qeverie për pezullimin e përkohshëm të qiradhënies nga njësitë e qeverisjes vendore dhe me përfundimin e sasisë që do t'i kalojë Agjencisë së Kthimit të Pronave do të rishikohet edhe një herë në tërësi...

Eduard Shalsi – Ka pezulluar atë që i ka dhënë?

Irfan Tarelli – Qiradhënia është e pezulluar nga njësitë e qeverisjes vendore, ndërkohë me një vendim të Këshillit të Ministrave i kanë kaluar 23 mijë hektarë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë me ndihmën e...

Eduard Shalsi – Nga fondi i tokave të pandara...

Irfan Tarelli – Nga fondi i tokave të pandara *de jure* dhe *de facto* ky kalim ka ndodhur dhe është bërë hedhja e tyre në hartat dixhitale, duke përdorur edhe imazhet satelitore nëpërmjet një programi shumë të avancuar.

A i është bërë ndonjë analizë këtij procesi, i cili parashikohet nëpërmjet këtij projektligji të mos dështojë?

Në fakt, ky është një proces shumë i komplikuar që me ligj është detyrë e njësive të qeverisjes vendore përmbyllja e procesit, por implikon edhe shumë agjenci të tjera shtetërore, duke filluar nga Agjencia e Kthimit të Pronave, ALUIZNI, prefektët, këshillat e qarqeve, Zyra e Regjistrimit të Pasurisë dhe një nga arsyet, që ka pasur vonesa në zbatim kanë qenë edhe mosangazhimi sa duhet i këtyre agjencive, për të kthyer në kohë përgjigjet rast pas rasti që ligji i detyron.

Unë do të mendoja që Ministria e Bujqësisë e vetme e ka të pamundur të përballojë procesin, por do të kërkohej një angazhim dhe koordinim i punës me shumë struktura qeveritare, me prefektë të qarqeve dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me njësitë e qeverisjes vendore. Megjithatë, gjykojmë që koha prej 1 viti, meqenëse procesi ka filluar dhe diku është në mes, diku

është në hapat fillestarë, për një periudhë 1-vjeçare mendojmë se është i mjaftueshëm për t'u mbyllur.

Lidhur me pyetjen sa është sipërfaqja dhe numri i përfituesve, në fakt, ne nuk kemi të dhëna të fundit për sipërfaqen, sa është sipërfaqja në total, sa është ndarë dhe sa pritet të ndahet, sepse procesi kushtëzohet nga aplikimi fillestar, pra aplikimi që bën individ. Edhe procedurat janë të rregulluara dhe do të rregullohen përsëri me një vendim të Këshillit të Ministrave që individ duhet të bëjë kërkesën dhe aplikimin, sepse njësitë e qeverisjes vendore e kanë të pamundur të fillojnë kryesisht procesin. Gjithsesi, nisur nga raportimet që ka Ministria e Bujqësisë nëpërmjet prefekturave, aq sa janë ndarë, mund të themi se procesi mund të jetë deri në 30%-40% të sipërfaqes, supozuar që do të përfitonin. Pikat kryesore ku procesi nuk ka ecur aq mirë, janë në b-Patosi, në b-Kukësi dhe disa në “b” të tjera, ku procesi është më sporadik.

Robert Bitri – Pyetja e Dashos duhet të ishte e zgjidhur para se ky projektligj të vinte këtu te ne, sepse, për hir të së vërtetës, ne bëjmë projektligje për të shtyrë afatin kur nuk dimë sa njerëz kemi për këtë projektligj dhe sa sipërfaqe kemi për të zgjidhur. Pa u mbyllur këto të dhëna, unë them se projektligji nuk duhet të vinte në parlament.

Eduard Shalsi – Në fakt, unë do të doja të mbanit shënim dhe të informonit edhe ministrin, edhe qeverinë, që komisioni do të donte të dinte statusin e statistikave të bujqësisë.

Ju, zoti përfaqësues i ministrisë, dhatë një shifër prej 650 hektarësh të tokës bujqësore, gjë që, në qoftë se do të ishte e vërtetë, do të ishim të gjithë shumë të lumtur, por druaj se mos diferenca midis letrave dhe realitetit, duke parë sesi është zhvilluar ultësira shqiptare dhe sa ndërtime janë bërë mbi sipërfaqe të tëra, të mos luajnë disa dhjetëra, por kam frikë se mos luan në qindra hektarë dhe ne si komision, për të kaluar pastaj te pyetjet dhe përgjigjet e të tjera, do të vlerësonim një informacion me statusin e statistikave në lidhje me bujqësinë.

Ne e dimë se Shqipëria është ende një magazinë pa inventar. Jemi në dijeni të përpjekjeve serioze që po bën qeveria, madje shumë shpejt do të fillojë edhe një fotografim, jo si ai i vitit 2007, por me parametra shumë më të mira se ai, që do të lejojë edhe një evidentim më të qartë të sipërfaqeve, qoftë të tokave bujqësore, qoftë të pyjeve, qoftë atyre urbane apo jourbane. Pra, do të doja t'i mbanit shënim, të informoni edhe ministrin që komisioni do të ishte i interesuar të dinte statusin e statistikave. Ne e dimë që ka të tilla, por nuk jemi të sigurt te saktësia e tyre, duke pasur parasysh se çfarë lloj censusi është bërë për bujqësinë dy vjet më parë.

Kalojmë te përgjigjet e pyetjeve të tjera. Ka pyetje që kanë ngelur pa përgjigje?

Majlinda Bogo— Lidhur me pyetjen: si veprohet për tokat shtet kur qytetarët shkojnë dhe aplikojnë me aktin e marrjes së tokës në pronësi në zyrat e regjistrimit dhe gjejnë sipërfaqen e tyre në gjendjen “shtet”, për mua si specialiste problemi është i zgjidhur, sepse akti i marrjes së tokës në pronësi është akti i kalimit nga pronësia e shtetit te pronësia e individit. Këtë veprim e kryen Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Pra, është e rëndësishme që qytetari të ketë aktin e marrjes së tokës në pronësi dhe kalimin nga pronësia e shtetit te pronësia e individit e bën sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, figuron shtet dhe ka filluar me procedurën nga fillimi, sipas ligjit të ri që nxorët në vitin 2013, që ishte për plotësimin e AMTP-së nga fillimi. Ndoshta është midis ministrisë dhe ZRPP-së, por...

Irfan Tarelli — Ka një pyetje për personat me mangësi dokumentacioni. Në fakt, nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e ligjit, por ministria jonë bashkë me Ministrinë e Drejtësisë janë duke rishikuar udhëzimin nr. 2 të Këshillit të Ministrave për regjistrimin e AMTP-ve dhe me një procedurë më të lehtësuar që të trajtojë rastet kur jo për faj të tij, pronari ka mungesë dokumentacioni, për shembull, në pjesë të formës, në ndonjë rast edhe të përmbajtjes. Një vendim i tillë do të kalojë shumë shpejt në Këshillin e Ministrave.

Për sa i përket pyetjes së zotit Shalsi: pse vjen kaq vonë ligji?, në fakt është pyetje dhe vërejtje e drejtë. Megjithatë ligji e humbiste fuqinë më 1 tetor, vendimet e qeverisë janë miratuar me vonesë dhe vetë ligji thotë se “procedurat e përfundimit të dokumentacionit zgjasin një vit nga miratimi i akteve nënligjore”, që koïncidon me periudhën e muajit prill të këtij viti.

U desh një kohë për të marrë informacionin e nevojshëm nga njësitë e qeverisjes vendore që si ka shkuar procesi, informacion i cili ka ardhur me mangësi dhe kjo shpjegon edhe hezitimin nga ana jonë për të dhënë shifra për pyetjen e zotit deputet.

Eduard Shalsi — E qartë.

Irfan Tarelli — Pastaj i kaloi edhe procedurat...

Eduard Shalsi — Pra, ligji, që është miratuar më 17 maj të vitit 2012 parashikonte të hynte në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërkohë që vonesa e akteve nënligjore solli për pasojë vonimin në zbatimin e ligjshmërisë.

Atëherë, të nderuar kolegë, në qoftë se nuk ka ndonjë...

Ka ndonjë vërejtje?

Dashamir Kamberi – Lidhur me përgjigjen e pyetjes, natyrisht që ndërhyjnë edhe dy kolegë deputetë. Unë mendoj se në parim absolutisht jemi në të njëjtin mendim që ky projektligj duhet të hyjë një orë e më parë, si të thuash, në veprim, por i gjithë problemi është, nga sa gjykoj unë, ndër të tjera, që një nga shkaqet, për të cilët ligji i mëparshëm, që është shumë i përafërt me këtë, nuk është realizuar, është edhe mungesa e njohjes së plotë të asaj pyetjeje që bëra edhe pak më përpara, që ka të bëjë me sipërfaqen dhe me numrin e përfituesve. Në qoftë se ne nuk do të vazhdojmë dhe ju për më tepër nuk do të keni këtë njohje të plotë, qoftë edhe mbi bazat e statistikave të mëparshme që sa tokë është dhënë në përdorim nga ndërmarrjet bujqësore dhe sa janë ata përfitues të djeshëm, do të na orientonte për të gjykuar më mirë, jo thjesht për afatin, por edhe për ta vënë këtë në funksion realisht, se ndryshe do të ndodhë që do të mbliidhemi përsëri, do të gjejmë një afat tjetër, madje do të kërkojmë edhe disa ndryshime të tjera.

Në përfundim, do të dëshiroja të thosha, duke qenë se edhe kryetari i komisionit e trajtoi si problem, unë mendoj se pa pasur një njohje të plotë për këtë problem dhe për të ardhur edhe një herë me një informacion pak më të plotë për këtë punë, do të ishte koha e nevojshme pas kësaj për t'u marrë dhe për ta definuar këtë si projektligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Kamberi!

Fjalën e ka zoti Bushati dhe pastaj zoti Kopliku.

Ervin Bushati – Kam një koment të shkurtër.

Faleminderit që u hap kjo temë, në radhë të parë, dhe që filloi, sepse ka diçka shumë të rëndësishme: nuk ka bujqësi pa tokë. Mund të ketë shumë gjëra të tjera pa tokë, por nuk ka bujqësi pa tokë.

U bë mirë që u hap dhe po merremi me këtë problem, por mendoj se, pavarësisht sa teori mund të ketë më vonë se si mund të diversifikohet, si mund të rajonalizohet apo si mund të mbliidhen, të bëhen bashkë me kooperativa e të gjitha këto bashkë, asgjë nuk mund të fillojë pa u sqaruar problemi i tokës në bujqësi. Më vjen mirë që ju e keni kuptuar këtë sfidë dhe ndoshta keni pozicionin më të vështirë.

Mendoj se do të ishte mirë të ktheheshim shumë shpejt në një strategji më të mirë, më të saktë dhe me afate kohore për t'u matur, ndoshta edhe me vetë ministrin e Bujqësisë, është mirë të ndeshemi dhe ta kapim deri prej brirësh në këtë pikë, sepse pa tokën nuk kemi bërë asgjë për bujqësinë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Kopliku.

Namik Kopliku – Në fakt, zotëria nga ministria përmendi që ndër shkaqet që titujt e pronësisë nuk arritën të shpërndahen brenda afatit të ligjit të kaluar, kishte objekte dhe subjekte.

Mendoj se këto i dimë shumë mirë, ashtu si procesi i legalizimit ishte proces elektoral, pra sa herë që afroheshin fushatat elektorale thuhej: “do të legalizohen shtëpi” dhe praktikisht u bë një numër shumë i vogël. Kuptohet që edhe ligji në vitin 2012 nga qeveria paraardhëse u bë me këtë qëllim që gjatë vitit 2013 të thuhet se po ndan edhe tituj pronësie, por ata nuk kishin ndër mend të bënin gjë.

Problemi që diskutoj unë tani është që përsëri futemi në vit elektoral. Përsëri po të lihet në dorë të subjektivizmit të faktorëve që ju përmendët, ku futet edhe pushteti lokal, mund të kemi vështirësi në respektimin e këtij afati. Pra, arsyet subjektive të fushatave të kaluara mund të jenë po arsye subjektive aty ku kanë pushtetin për ta penguar ecurinë e shpejtë të këtij procesi.

Po ashtu, mungesa e statistikave nga ana juaj mund të jetë pasaktësi në vendosjen e afatit në fund të vitit 2015. Unë nuk e kuptoj çfarë humbasim po të themi edhe fundi i vitit 2017. Ku e keni problem ju? Pse i vini një kufi? Ju, po ishit të zotë, mbaroni edhe në qershor të vitit 2015. Po pse duhet të vëmë një kufi, siç ishte kufiri në fund të vitit 2013, që nuk u respektua, nuk ndodhi asgjë përveçse duhet të merrje vendim me ligj edhe një herë.

Pra, nuk keni statistika plotësisht të sakta. Kur themi ju, shteti ynë, jo ju.

Ju keni problematikë që mund të jetë e dukshme në procesin zgjedhor të vitit të ardhshëm. Pse duhet ta vëmë këtë kusht “në fund të vitit 2015” dhe këtë nuk e bëj pyetje, pasi e bënë shokët, madje u vu detyrë nga komisioni që të shikoni edhe një herë dhe më mirë bazën e të dhënave, statistikën që keni, pasi duke i parë më me vëmendje, mund t'ju ndihmojnë edhe ju për të qenë më të sigurt në veten tuaj që po e realizoni.

Ju e kërkon këtu afat që në fund të vitit 2015, ne jua miratojmë si projektligj, por në fakt ju do të bëni punën. Nuk duket se ju jeni të sigurt që e bëni, përveçse thotë: Ne e bëjmë deri në fund të vitit 2015, por na mungojnë këto të dhëna, këto të dhëna e me radhë.

Në këtë aspekt...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Lëreni ta mbarojë!

Namik Kopliku – Jo, nuk e vë ministria. E tha zotëria që ka lidhje me sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pushtetin vendor e kështu me radhë. Pra, bëhet edhe më e vështirë për ju për të paraqitur një projektligj që thoni se e bëni brenda vitit 2015, një gjë që nuk varet fare nga ju. Sikur të varej nga ju, keni edhe problemin që nuk keni statistika shumë të plota. Në qoftë se e shqyrtoni këto ditë deri sa të kalojë edhe në komisionin përgjegjës, në qoftë se mund të shqyrtoni edhe një herë si janë forcat tuaja dhe të dhënat që keni, mund të propozoni një ndryshim.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ndoshta, zoti Kopliku, meqenëse zoti Irfan është prej një kohe të gjatë në Ministrinë e Bujqësisë, e ka parë ritmin me të cilin ecën qeverisja e Rilindjes dhe tashmë është më optimist, sepse afatet do të zbatohen. Gjithsesi, do të doja ta mbanit shënim çështjen e afatit, sepse sinjerisht, kur vendosim afate, nuk i kemi qëllim në vetvete, janë afate brenda të cilëve objektivat duhet të realizohen.

Para se të kalojmë në votim, unë kam thjesht disa sugjerime, që do t'ia çojmë edhe komisionit përgjegjës, të cilat kanë të bëjnë më shumë me aspektin formal. Do të sugjerim që nga pikëpamja e teknikës ligjore të ketë disa rregullime për çdo nen apo grup nenesh.

Neni 1 “Qëllimi”.

Neni 2 “Subjektet”.

Neni 3 “Sfera e veprimit të këtij ligji”.

Pra, nenet të emërtohen sipas qëllimit për të cilin shërbejnë. Të shikohet termi “përfutuese” me termin “përdorues”. Shpjegimet do t'ia bëni komisionit përgjegjës, kurse ne thjesht po bëjmë disa sugjerime.

Duhet parë riformulimi i pikave 5 dhe 6 të neni 3 në lidhje me një vendim përfundimtar të formës së prerë, që është ai që i jep titullin e pronësisë ish-pronarit apo atij që pretendon një të

drejtë pronësie. Pra, janë disa sugjerime që vijnë nga specialistët e teknikës ligjore, të cilat do t'ju vëmë në dispozicion edhe juve, edhe komisionit përgjegjës.

Të nderuar kolegë, përpara se të kalojmë të dëgjesa për zonat me përparësi turizmin, e hedhim në votë.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Për këtë nen do ta bëjmë sugjerimin të materiali që do të çojmë. Kush është dakord me propozimin e zotit Kopliku dhe të zotit Bitri për shtyrjen e afatit me një vit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Duke ju falënderuar, do t'ju lutem t'ia transmetoni edhe ministrit kërkesën e komisionit në lidhje me statusin e statistikave. E dimë që janë problem, por duhet ta dimë se në çfarë faze janë dhe çfarë do të bëjmë për të marrë disa të dhëna. Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.12.2014, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit për prezantimin e ecurisë së procesit për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Robert Bitri, Artan Gaçi, Esmeralda Shkja, Fatmir Toçi, Artur Bushi, Besnik Baraj, Piro Kapurani, Ervin Koçi, Namik Kopliku, Gentian Bejko, Rakip Suli, Bujar Derveni, Vladimir Kosta, Ervin Buashti, Dashamir Kamberi, Erjeta Alhysa dhe Blerina Gjylameti.

Mungojnë:

Genc Ruli, Sherefedin Shehu, Ardian Turku, Agron Duka, Besnik Dushaj, Voltana Ademi, Gjergji Papa, Helidon Bushati, Kozma Dashi, Dashamir Tahiri, Parid Cara, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi dhe Monika Kryemadhi.

Të ftuar:

Alfred Dalipi – zëvendësministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Sonia Popa – drejtoreshë e Përgjithshme e Turizmit

Alba Canaj – specialiste në Drejtorinë e Zhvillimit Urban

Albana Kocollari – specialiste në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Edhe një herë përshëndetje, të nderuar kolegë!

Sikurse njoftuam, sot do të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit: zotin Alfred Dalipi, zëvendësministër (Është kënaqësi t’ju shohim, ish-kolegu ynë), zonjën Sonia Popa, drejtoreshë e Përgjithshme e Turizmit, zonjën Alba Canaj, specialiste në Drejtorinë e Zhvillimit Urban, si dhe zonjën Albana Koçollari, specialiste në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Ju uroj mirëseardhjen! Unë ju informova, të nderuar kolegë, në lidhje me një relacion për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin, të cilin ministria na i dërgoi disa kohë më parë dhe unë gjykova ta dëgjonim dhe ta ndanim bashkë.

Është një dokument mbi të cilin duhet të reflektojmë dhe të mendojmë, si dhe të paraqesim, nëse ka, vërejtje, sugjerime apo komente. Për mua kjo është një qasje e re shumë interesante që nuk është në vazhden e modelit të trajtimit të territorit në mënyrë kaotike, siç ka ndodhur rëndom gjatë dekadave të fundit. Pasuria kulturore, natyrore, historike, peizazhet e territorit shqiptar, pozita e favorshme gjeografike kanë ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit, por ato nuk janë shfrytëzuar për shkak të qasjes, të mungesës së vizionit apo edhe për shkak të mënyrës si kanë funksionuar agjenci të ndryshme.

Pa humbur kohë, fjalën e kanë përfaqësuesit e ministrisë. Keni 10-15 minuta në dispozicion për të folur para komisionit. Nëse kolegët do të kenë pyetje, mund t’i bëjnë më pas.

Alfred Dalipi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të ndalem vetëm një minutë për t’i bërë një përmbledhje aktit. Dokumenti që paraqesim në komision, në sajë të iniciativës suaj, është një draft, pra është në statusin e projektit dhe bazohet në ligjin e ri për planifikimin e territorit. Është një detyrim ligjor dhe lidhur me atë që thatë ju se është një qasje e re, kjo nuk është vetëm një qasje e re, por është një dokument i ri dhe që nuk ka qenë hartuar më parë.

Përcaktimi i zonave më përparësi zhvillimin e turizmit ka qenë një projekt i lançuar në vitin 1993 nga qeveria “Meksi”, por mbeti gjithmonë një projekt, duke mos marrë asnjëherë formën e një dokumenti përfundimtar, të një akti ligjor apo nënligjor. Pra, jemi shumë afër një akti nënligjor, që do të jetë rrjedhojë edhe e ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit në

Republikën e Shqipërisë”, që parlamenti e miratoi në fillim të këtij sesiioni. Gjithçka që është paraqitur këtu është ende në statusin e mendimmarrjes, që do të thotë se të katër hapat që ka ndjekur Ministria e Zhvillimit Urban në fushën e planifikimit, të rregullimit, të përcaktimit të legjislacionit në fushën e turizmit dhe të përcaktimit të zonave plotësojnë të gjithë kuadrin ku do të zhvillohet veprimtaria në fushën e planifikimit dhe në fushën e zhvillimit të territorit, konkretisht në zhvillimin e turizmit. Përcaktimi i zonave më përparësi turizmin në këtë akt nënligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë do të interferojë dy ligje: ligjin e planifikimit dhe ligjin e turizmit, të cilin sapo e kemi përcjellë në Këshillin e Ministrave. Ne kemi hartuar një dokument të cilin do ta prezantojmë dhe jemi të hapur për çdo pyetje.

Kërkoj ndjesë për zërin dhe, që të mos jem acaruar për komisionin, po i jap fjalën për të bërë prezantimin zonjës Alba Canaj, që është edhe specialiste në këtë fushë.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Dalipi!

Kam një pyetje. Ju thatë se ligji për turizmin ka kaluar në qeveri apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është ende në proces shqyrtimi, por ka përfunduar draftimi; është futur edhe ligji për investimet e huaja, apo jo?!

Alfred Dalipi – Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit e ka përfunduar si draftim prej kohësh dhe ndoqi paralelisht praktikën që ligji për partneritetin publik-privat dhe ai i investimeve të huaja të kalonte bashkë me ligjin për turizmin në Këshillin e Ministrave, meqë në të tria ligjet kishte interferenca. Ne e kemi paraqitur ligjin tonë, tani presim që ministritë e linjës të paraqesin dy ligjet e tjera.

Eduard Shalsi – Dua t’i rikujtoj zotit Gaçi, që do të jetë relatori për këtë çështje, se edhe ne duhet të fillojmë që tani të jemi pjesë e procesit për të kursyer kohë kur të vijë të diskutohet në komision.

Fjala është për zonjën Canaj.

Alba Canaj – Përhëndetje të gjithëve!

Turizmi, si një sektor i rëndësishëm për rritjen ekonomike, si dhe duke parë pasuritë e shumta kulturore, historike, peizazhet e territorit shqiptar dhe pozitën e favorshme gjeografike, që të zhvillohet kërkon një përkujdesje të madhe në lidhje me planifikimin, me rregullimin, me zhvillimin e territorit. Kjo gjë, duke u parë konkretisht, ka shumë probleme nisur edhe nga

zhvillimi kaotik i dekadave të fundit, gjë që e pengon dhe nuk i jep mundësi favorizuese zhvillimit të turizmit, që është një ndër prioritetet e ministrisë sonë.

Nisma e radhës e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit është rishikimi i VKM-së nr. 88 e vitit 1993. Në vitin 1993 kjo ka qenë në nivel drafti, duke përcaktuar zonat me potencial me përparësi zhvillimin e turizmit. Faktikisht, duke qenë një VKM e pa miratuar dhe në nivel drafti, është një ndër hapat që ne i jemi referuar edhe në kuadër të ligjit për turizmin që kemi në proces për miratim, edhe të ligjit të ri të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Propozimi i radhës në ndihmë të planit të përgjithshëm kombëtar, është një ndër sektorët për evidentimin e zonave me përparësi turizmin. Në këtë fazë, ne kemi kërkuar rishikimin e kësaj harte të mëparshme dhe propozimet e reja lidhur ngushtë edhe me vendimet e mëtejshme të po kësaj date, por edhe me gjendjen aktuale lidhur me terrenin.

Procesi i punës ka nisur me koordinimin dhe hartimin e raportit paraprak, një bashkëpunim në gusht të këtij viti midis Ministrisë dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Më pas ka vijuar me skanimin dhe propozimin paraprak lidhur ngushtë me një grup ndërministror, që ministria e pa si një ndër pikat kyçe për zhvillimin dhe kompleksitetin e çështjeve që përfshijnë turizmin.

Në tetor ka vijuar me përcaktimin në parim të zonave me përparësi turizmin, në bashkëpunim edhe me mendimet dhe propozimet e marra nga grupi ndërministror, dhe është bërë hartimi i raportit dhe drafti i hartës paraprake për zonat e propozuara.

Ky material u ka kaluar të gjitha ministrive për marrje mendimi, jo vetëm atyre që janë të përfshira në grupin ndërministror, dhe procesi vijon me hartimin e kërkesës për nismën për KKT, dhe më pas me miratimin e saj.

Qëllimi i këtij procesi është për të mbështetur zhvillimin e turizmit, për të përmirësuar situatën aktuale të zhvillimit të territorit në zonat turistike, për të përfshirë në këto zona hartimin e planit të përgjithshëm kombëtar, atë që aktualisht është në proces, dhe jemi në fazën e analizave tematike.

Jemi në proces të planit të integruar ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës dhe planit të integruar ndërsektorial për Bregdetin, për të krijuar një platformë mbi të cilën mund të hartohen plane të detajuara për zhvillimin e zonave me përparësi turistike, e orientuar kjo dhe nga njësitë qendrore vendore edhe nga ministritë e linjës për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në

zona me përparësi turizmin, për të mbrojtur dhe konservuar pasuritë natyrore, kulturore, historike dhe peizazhin.

Kjo, për të cituar edhe një faktor tjetër të rëndësishëm, peizazhin, që deri tani nuk ka qenë një ndër elementet për zhvillim turizmi dhe është një nismë e re dhe një ndër pikat që ne propozojmë në kuadër të zonave më përparësi turizmin.

Synimi është politika turistike për krijimin e një modeli turizmi gjithëvjeter të integruar. Deri tani, ne kemi një zhvillim turizmi sezonal dhe në zona të përcaktuara kryesisht përgjatë vijës bregdetare.

Meqenëse ne kemi mundësi kulturore, natyrore dhe bregdetare, këtë sezon duam ta përfshijmë për gjatë gjithë vitit, lidhur ngushtë me mundësitë edhe me faktin se nuk mund të kemi vetëm një kategorizim bregdetar të turizmit, por gjithëpërfshirës për produktet turistike tërheqëse, konkurruese në destinacionet turistike dhe duke nxitur investime të qëndrueshme në fushën e turizmit, kjo e mbështetur me politika dhe me paketa fiskale lehtësuese për këto zona të miratuara.

Për sa u takon koncepteve lidhur ngushtë me planin e integruar ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës, ndër të tjera, është hedhur edhe propozimi për *mais turizmo* si qendër konferencash, ekspozitash, konventash, për ta orientuar vendin në një drejtim të ri për sa i takon destinacionit dhe pozicionit gjeografik në rajon, falë edhe mundësive për zhvillim të mëtejshëm në këtë sektorë.

E njëjta gjë është e lidhur ngushtë edhe me turizmin aktiv lidhur me sporte, të tipit aeronautik, alpinizëm, ecje malore, çiklizëm, really etj. Njëkohësisht, një mbështetje për agroturizmin, për përmirësimin e cilësisë të shtëpive pritëse të zonave rurale autentike, si një benefit i mirë që ne e kemi aktualisht, nxitje dhe mbështetje të veprimtarive artizanale dhe argëtuese, kjo e lidhur dhe me turizmin pasiv, si një alternativë zhvilluese për resorte, shtëpi pushimi, marina, e lidhur me pjesën bregdetare dhe shtrirje më në brendësi të vendit.

Pra, kategoritë që unë citova pak më lartë, tregojnë gjerësinë e zhvillimit të turizmit, pra jo vetëm sektori i deritanishëm që ne e kemi të njohur brenda Republikës së Shqipërisë.

Përfshirja e ministrive të tjera, bazuar në tre produktet kryesore të strategjisë së turizmit, si kultura, natyra, zhvillimi rural dhe bregdeti, janë me disa nënkategori, që ne i kemi cilësuar brenda grupit, fillimisht të ministrisë, por përfshirë ndërinstitutionalizimin e saj për tematikat që

lidhen me kulturën dhe trashëgiminë e ndërtuar: mjedisin, promovimin e vlerave të veçanta mjedisore, sportin, turizmin aktiv, auronautikën, alpinizmin, ecjet malore, turizmin pasiv, shëndetësinë, edukimin, bujqësinë, turizmin për kazino, kënaqësitë e tjera alternative, turizmin e trendeve të reja për t’u eksploruar.

Duke parë kompleksitetin e këtyre gjerave, ne kemi kërkuar suportin dhe mbështetjen e ngritjes së një grupi ndërministror, me përfaqësi dhe nga ministri të tjera të cituara pak më lartë.

Bazuar në ligjin nr. 10119 “Për planifikimin e territorit”, nisma për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin ka nisur në muajin gusht 2014, ndërkohë që ligji i ri, ai që cituam, numër 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ka hyrë në fuqi në datë 1 tetor.

Për përcaktimin e zonave me rëndësi kombëtare ne kemi përfshirë aspekte të ndryshme: trashëgimitë territoriale natyrore dhe antropogjene, ekonomike dhe sociale, kompleksitetin e çështjeve nga pikëpamja institucionale.

Grupi ndërministror i punës është kryesuar nga zoti Alfred Dalipi, zëvendësministër i ministrisë sonë dhe ka vijuar me përfaqësi nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, njëkohësisht edhe nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Për sa citova më lart, për procedurën ligjore i jemi referuar ligjit të vjetër të Planifikimit të Territorit, ku citohet se, zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, ka qenë një ndër pikat e nenit 6 shkronja a e këtij ligji, që ne kemi propozuar edhe këtë nismë. Duke e lidhur edhe me ligjin e ri të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, ajo nuk citon më në paragrafin e saj përparësi për zhvillimin e turizmit, por në rast se për çështjet me rëndësi kombëtare, duke iu referuar planit të përgjithshëm kombëtar që ne jemi në proces hartimi, mund të propozohet nga ministria e linjës përkatëse nisma në kuadër të saj.

Kjo nismë me përparësi në zhvillimin e turizmit është një ndër shtresat që i atashohet planit të përgjithshëm kombëtar. Pjesëmarrës në këtë grup ministror ka qenë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Deri tani ne kemi evidentuar vendimet, studimet, zonat e miratuara të mëparshme, ajo që ishte harta e vitit 1993 në nivel drafti, vendimet e KRTRSH-së dhe KKT-së së sotme për këto zona, të cilat ne i kemi cituar si zona me përparësi turizmin, instrumentet e planifikimit vendor që janë të miratuara dhe që përfshijnë këto zona që ne i kemi cilësuar si zona me prioritet

turizmin. Të gjitha këto janë hedhur në një draft-hartë për zonat me përparësi turizmin, pra, të gjitha suportet, miratimet dhe propozimet, qoftë nga ministritë e grupit të punës qoftë nga miratimet që janë aktualisht në këto territore të mbivendosura në një hartë të vetme.

Është përcaktuar një raport, ky është materiali që u është kaluar të gjitha ministrive bashkë me hartën-draft për zonat me përparësi.

Kjo është harta që u është kaluar të gjitha ministrive për mendim, mund të shikoni identifikimin e njollave përgjatë gjithë sipërfaqes së territorit të Shqipërisë. Kjo është hartë paraprake e zonave me përparësi turizmin dhe deri tani janë marrë mendime nga ministri të tjera.

Rëndësi të veçantë, për të cilën ne presim suport, mbështetje dhe mendime nga tre ministritë kyçe që u takojnë këtyre zonave, është Ministria e Bujqësisë së Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Kulturës, kjo e lidhur me problematikat që mbulon në zonat me përparësi turizmin dhe njëkohësisht, edhe lidhjen midis tyre. Kjo ishte në parim.

Për politikat fiskale të lidhura ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ne propozojmë që këto zona (do të përcaktohen kufijtë e mëtejshëm) të kenë lehtësira për zhvillim, pra, të mos ketë më politika për centralizimin e turizmit, por të ketë gjithëpërfshirje dhe mundësi për ta zgjeruar hartën e zhvillimeve të turizmit.

Eduard Shalsi – Faleminderit, për prezantimin!

Të nderuar kolegë, keni fjalën për pyetje.

Zoti Bushati, keni fjalën! Më pas, zoti Gaçi!

Alba Canaj – Po ju nxjerr hartën.

Ervin Bushati - Faleminderit!

Unë kam tri pika, të cilat janë diskutuar edhe më parë, por mendoj se ia vlen t'i përsërisim.

E para është konceptuale për mendimin tim. Gjithmonë dëgjojmë për turizmin dhe nuk e marrim gjithmonë konceptin klasik apo klishe se çfarë mendojmë për turizmin, ndërkohë, realiteti është pak më ndryshe (të paktën kështu më duket mua).

Në radhë të parë turizmi duhet të jetë për shqiptarët. Ne jemi importues turizmi dhe shumica e shqiptarëve bëjnë pushimet më shumë jashtë, sesa në Shqipëri, sepse nuk i gjejnë kushtet këtu. Ndërkohë, që ne presim të na vijnë turistët e shumëpritur, njësoj si investimet e

huaja. S'kemi mundur të krijojmë nivelin e duhur të shërbimit, për t'ju shërbyer në radhë të parë, shqiptarëve. Shqiptarët që jetojnë në Shqipëri e bëjnë turizmin jashtë vendit, sepse kanë kushtet, qetësinë, shërbimin dhe mentalitetin e shërbimit ndryshe. Ata e gjejnë dhe relaksohen në vende të tjera. Kjo duhet të jetë sfida e parë dhe shumë e rëndësishme. Më pas vijnë të tjerat, kur ne të kemi në rregull shtëpinë tonë. Nëse nuk rri i zoti i shtëpisë, s'mund të presësh të vijnë miqtë.

Kjo është çështja e parë dhe shumë e rëndësishme. Kështu duhet parë si dimension zhvillimi i turizmit. Prandaj ju thashë që është pak tej klasikes. Ne e mendojmë turistin, si dikush që është biond, vjen nga Veriu dhe s'kupton asgjë nga shqipja. Turisti duhet të jetë shqiptar që harxhon këtu dhe më pas, le të jetë edhe ky i dyti.

Pika e dytë, është shumë e rëndësishme: turisti për mendimin tim është si graviteti, ndodh vetëm aty ku do dhe jo aty ku duam ta çojmë ne apo si e imagjinojmë ne. Në të gjitha vendet e botës pikat që kanë më shumë volum ekonomik, janë qendra administrative (unë e shoh si ekonomist). Roma për Italinë, Londra për Anglinë, Parisi për Francën, Nju Jorku për Amerikën, pra, gjithmonë janë qendrat më të mëdha. Njerëzit shkojnë aty, sepse turizëm quajnë edhe pjesën e sjelljes së shoqërisë duan të shohim sesi jetojnë ata njerëz dhe pastaj janë devijime apo shumë pjesë të vogla, të eksploratorëve që mund të jenë më pak se 1/100 (të paktën në sensin ekonomik), që shkojnë të eksplorojnë gjërat më të çuditshme apo më ekzotike dhe Tirana nuk është parë asnjëherë, si qendër që mund të ketë potencial turistik, ndërkohë ka. Po të shihen shifrat, 80% e turizmit është këtu, në Tiranë.

S'mund ta çojmë në vend tjetër, kur njerëzit vijnë këtu, gravitojnë këtu. Bashkia e Tiranës duhet të ishte interlokutori kryesor dhe më pas të ishte Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë, Bashkia e Durrësit, sepse këtu do të vijnë turistët. Ta harrojmë se do të shkojnë në vende të tjera. Po s'u bë Petrela, Preza, Ndroqi, (3 kalatë kryesore të Tiranës), po s'u bë aeroporti...

Edhe për 20-30 vjet, të gjithë në Tiranë kanë për të ardhur.

E treta, që mendoj se është e lidhur me këtë, është sensi etnografik. Ne s'kemi vetëm pasuri natyrore. Turizmi nuk vjen vetëm nga pasuritë natyrore. Shumë njerëz vijnë për kuriozitet, sepse këtu është një popull që bashkekziston me 3-4 fe, që ka jetuar gjithmonë në Ballkan, që është autokton, që ka një histori të lidhur me disa pjesë të tjera të botës etj. Kjo pjesë, kultura,

është shumë e rëndësishme, vlerat tona të veçanta që kemi dhe më pas vijnë ato të tjerat. Sa veta mund të zbresin deri në Finiq apo diku tjetër? Besoj se janë degëzime të vogla. Qendra kryesore ka për të qenë këtu. Këtu marrin erën, parfumin e Shqipërisë. Shumica e njerëzve rrinë 5 ditë në një vend dhe më pas, largohen. Ajo që mbetet është eksperiencia e asaj që kanë dhe kaluan në atë vend.

Këto mendoj se janë 3 pikat që duket sikur janë përtej asaj që ne mendojmë për turizmin, kur e shohim si pikturë, por në fakt, janë sensi ekonomik dhe ajo çfarë na mbetet neve si ekonomi, sepse pavarësisht se vijmë nga rrugë të ndryshme, qëllimi ynë i përbashkët është zhvillimi i Shqipërisë. Unë dhashë mendimin tim si ekonomist.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bushati!

Zoti Gaçi, keni fjalën!

Më pas, zoti Toçi!

Këto nuk ishin pyetje, por ishin sugjerime apo rekomandime, të cilat bëhen në fund.

Artan Gaçi – Faleminderit, zoti kryetar, që më caktuat relator!

Unë mendoj se është një përgjegjësi shumë e madhe sepse nuk e konsideroj këtë ligj si ligjet e tjera që vijnë në komision, por e konsideroj këtë ligj dhe këtë reformë, si një prioritet kombëtar. Nëse do të ketë të ardhme Shqipëria, nëse do të ketë mirëqenie, gur themeli do të jetë turizmi në Shqipëri. Kështu që do të mundohem që të jap së bashku me kolegët, kontributin maksimal jo si për një ligj të zakonshëm. Do të njihemi më mirë me materialet dhe do të diskutojmë hap pas hapi. Nuk besoj që në këtë prezantim të parë, të shpejtë mund ta zbërthejmë dhe të japim argumentet tona, por unë kisha një 3-4 pika, të cilat ndoshta mund të ishin pjesë e kësaj strategjie kombëtare për turizmin.

E para, është Tirana, e cila siç e tha edhe kolegu, vazhdon të jetë atraksioni më i madh turistik i vendit dhe kështu do të vazhdojë edhe për shumë vite.

E dyta, janë disa mënyra të reja të të bërit turizëm, të cilat duhen shtuar te turizmi tradicional. Kemi një fluks të madh turistësh për diell që shkojnë në vendet arabe dhe ndërkohë, kemi kthimin e turistëve arabë që vijnë në Europë për kushtet klimaterike. Ka shumë vende afër nesh, siç është Bosnja që po krijojnë kushte për verimin e banorëve të pasur të vendeve të nxehta. Shqipëria i ofron këto jashtëzakonisht mirë, jo vetëm në zonat malore që kemi rreth e

rrotull Tiranës, por kudo nëpër Shqipëri. Mendoj se nuk është për t'u neglizhuar, sepse flitet për shuma të mëdha, është turizëm shumë i pasur. Janë familjet e të pasurve të Arabisë që verojnë nëpër Europë dhe nuk duan qendra urbane, por duan qendra klimaterike.

Një tjetër lloj turizmi, është turizmi mjekësor që po shfrytëzohet shumë mirë nga të gjitha vendet evropiane, në shumë drejtime. Po zhvillohet edhe në Shqipëri në mënyrë sporadike (për sa i përket mjekimit të dhëmbëve etj).

Kisha edhe një çështje tjetër që për mendimin tim është një nga veçantitë tona si shtet: ne ngjajmë me Izraelin, sepse te ne dhe në Izrael, përplasen të gjitha fetë kryesore të botës. Turizmi religjioz duhet të stimulohet. Për shembull Kisha e Laçit apo Mali i Tomorrit ku shkojnë me dhjetëra mijëra njerëz në vit. Kjo nuk është për t'u neglizhuar. Shqipëria dhe Izraeli janë vendet, ku përplasen të katër fetë kryesore. Jemi në kufijtë e ortodoksisë e katolicizmin (vija e Theodhosit është mbi Tiranë), jemi në kufijtë e myslimanizmit me krishtërimin, kemi Qendrën e Bektashinjve, kemi gjurmë të rëndësishme të hebrenjve. Të gjitha këto janë argumente për t'u shfrytëzuar. Po të shkoni në Izrael ose në Itali apo në Mekë, e shikoni se çfarë rëndësie të jashtëzakonshme ka ky lloj turizmi.

Po e mbyll me këto 3-4 sugjerime, por do të jemi bashkë dhe do të japim kontributin maksimal, që kjo gjë të kalojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Toçi, keni fjalën!

Fatmir Toçi – Do të flas shkurt, sepse prezantimi sapo u bë. E quaj shumë të rëndësishme këtë nismë të pazakontë, që qeverisja jonë ka marrë përsipër ta çojë vendin përpara. Është për t'u përshëndetur fakti që ka filluar seriozisht vlerësimi i turizmit si një degë shumë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare. Deri më sot ka pasur vetëm statistika për numrin e turistëve që kanë hyrë dhe kanë dalë. Me ato statistika të turizmit mbahej e gjithë politika shqiptare, duke zbritur në nivele groteske nganjëherë dhe unë e kam parë veten ato 3-4 herë që kisha dalë jashtë shtetit, isha i barabartë me ata 3-4 turistë që kishin hyrë dhe kishin dalë nga Shqipëria. Në fakt kjo është një nismë shumë e mirë. Ne nuk i kemi marrë elementet e detajuara nga ajo hartë dhe desha vetëm të them se në raport me vlerësimin e turizmit, që kishim gjatë sezonit turistik të verës, me turizmin gjithëvjetor që na e sjell turizmi malor apo turizmi i kombinuar, siç është turizmi kulturor apo ai i formave të tjera. Edhe në hartë po ta shikojmë

kemi një vijë bregdetare të zënë me idetë apo me programet që keni ju për zhvillimin e turizmit, dhe po të shikojmë pjesët e tjera të Shqipërisë si Veriu dhe vija malore, janë më bosh. Po të keni parasysh se e gjithë vija bregdetare ka vetëm 2 muaj turizëm (në rastin më të mirë, vetëm 3 muaj, duke u shtrirë në jug. Dhe e gjithë pjesa tjetër e vitit është pothuajse, i shkretë nga kjo pikëpamje.

Turizmi, që e gjithë bota po e zhvillon me programe ekstensive, është turizmi në të gjithë territorin, gjatë gjithë vitit, është turizmi malor me të cilin mendoj se, kur ta shikojmë, do të kemi edhe propozime konkrete secili për zonën e tij, për t'i dhënë zhvillim gjithëvjetor kësaj dege të turizmit.

E dyta, e cila mund të ishte në formën e një pyetjeje: ne po flasim për turizmin, për përmirësimin e kushteve, për zhvillimin e shumanshëm të turizmit. Si shoqërohet kjo me projekte për zhvillimin e infrastrukturës (flasim për infrastrukturën rrugore, por duhet menduar infrastruktura me të gjitha elementet e saj që kanë të bëjnë me furnizimin me ujë, energji elektrike etj.), sepse s'mund të pretendojmë për të ofruar një shërbim turistik, as për shqiptarët dhe as për të huajt, kur kemi probleme në infrastrukturë?

Nëse ky projekt s'do të jetë i mbështetur (është fat që është e njëjta ministri që mbulon dhe rregullimin e territorit), ndoshta është një nga çështjet që duhet mbajtur në konsideratë.

E fundit, e lidh ndoshta me një aktivitet që institucioni juaj do ta zhvillojë javën e ardhshme, si e shikoni ju këtë lloj turizmi, të gërshetuar me turizmin në rajon? Shqipëria është një vend shumë i pasur dhe i larmishëm me turizëm, por gjithsesi, është një vend me territor të vogël dhe rrethohet nga vende me territore të vogla. Një bashkëpunim mes këtyre vendeve të rajonit, do të jepte një zhvillim edhe turizmit tonë, jo vetëm si shkëmbim përvoje, por si shkëmbim real turistësh që kur vijnë në një vend si Ballkani, të shikojnë disa vende dhe Shqipëria të mos mbetet jashtë kësaj harte.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Shkjau, keni fjalën!

Esmeralda Shkjau – Falënderoj, përfaqësuesit e ministrisë!

Falënderoj, veçanërisht, Albën për prezantimin!

Në fakt unë kam një paqartësi: kur flasim për turizmin, flasim për problemet që ka turizmi, por në këtë prezantim nuk thamë se cilat janë zonat turistike të reja, që keni vendosur ju si ministri?

Një tjetër pyetje e cila është më shumë si sugjerim, sepse u çekën shumë mirë të gjitha problematikat nga kolegët: unë kam një çështje shumë të rëndësishme, e cila është ushqimi. Nëse shikojmë menunë në të gjitha vendet e Shqipërisë dhe do të shikojmë menu italiane dhe greke, ndërkohë, sa incentiva keni ju si ministri për të dhënë një opsion që turistët shqiptarë të kenë opsione për të dhënë ushqime tradicionale shqiptare?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Interesante, të dyja çështjet që shtroi zonja Shkja.

Zoti Koçi, keni fjalën!

Ervin Koçi – Pasi dëgjova kolegët, mendoj se ndaj disa mendime ndryshe. Ne kemi edhe një lloj turizmi tjetër me shumë vlerë, që është turizmi antik. Ne kemi qendra arkeologjike shumë të rëndësishme arkeologjike, si Butrini, Apolonia, Bylisi në pjesët e vendit që janë totalisht të pashfrytëzuara.

Kur flasim për turizëm, duhet të largohemi nga ato ndjenjat e zonave që përfaqësojmë, pasi është shumë herë më gjerë. Unë nuk besoj që Tirana do të jetë ndonjëherë qendra më e rëndësishme turistike e Shqipërisë për shkak se nëse kryeqytetet e tjera janë të tilla, janë për shkak të arsyeve historike dhe gjeografike, ndërsa Shqipëria, duam apo s'duam, ka vetëm 3 orientime turistike kryesore: turizmi bregdetar, turizmi malor dhe turizmi antik. Të tjerat janë derivate që mund të shfrytëzohen, por që janë epiqendra. Janë këto të shoqëruara edhe me turizmin malor, siç është pjesa veriore e Shqipërisë, që është një pjesë shumë e bukur.

Gjithsesi, unë do të doja nga zonja e ministrisë të na bëjë një shpjegim shkurtimisht të hartës, ku të tregojë çfarë janë ato të verdhat, jeshilet dhe lejlatë për të qenë edhe ne pak më të orientuar.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Fjalën e ka zoti Kopliku.

Namik Kopliku – Kam vetëm një sugjerim. Në këtë komision sapo erdhët me draft, siç e vutë re, pati shumë diskutime. Do të keni të amplifikuar diskutimet dhe propozimet në çdo ambient që të shkoni, por unë do të doja t'ju bëja një sugjerim. Meqenëse thoni: “zona me

përparësi”, t’i kushtoheni edhe më pak këto zona, pasi turizëm le të kemi në të gjithë Shqipërinë, se do të themi: zonat me përparësi duhet të jenë edhe më të përqendruara. Pra, ku është përparësia në zona që turizmin e kanë përparësi? Turizmi le të zhvillohet në të gjithë Shqipërinë. Po qe se i keni përparësi të gjitha zonat e Shqipërisë, në këtë mënyrë nuk kemi askund përparësi.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka ndonjë koleg tjetër diçka për të thënë?

Unë kam vetëm një pyetje, që është edhe në formën e një sugjerimi ose komenti: a keni bërë një analizë të tipologjisë së turistit? Pra, ku shkon ai që largohet nga Shqipëria dhe çfarë shërbimesh merr. Kemi rastin e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh që shkojnë në Turqi dhe sigurisht zgjedhja është një turizëm pasiv, një javë (10 ditë) të mbyllur në një hotel (relaks, ushqim, det).

Pra, një lloj analize të atij që largohet nga Shqipëria, ku shkon.

Tjetra ka të bëjë me tipologjinë e turistit që vjen në Shqipëri. Le të jemi të ndërgjegjshëm që kemi konkurrentë goxha të fortë, si Greqia fqinje, Italia, Mali i Zi dhe Kroacia më tej.

Vërtet zoti Bushati, me të cilin ndaj të njëjtin opinion me një pjesë të konsiderueshme të mendimeve që ai dha, por Roma është Romë përpara se të jetë qendër administrative dhe një qendër antike me pasuritë e njerëzimit. Po ashtu, edhe Parisi ka disa nga *landmark*-et më të fuqishme apo Londra, por kemi një rast konkret, Bunk’ Art-in. U hap para pak ditësh dhe, në fakt, statistikatat tregojnë që ka një frekuencë, një numër të jashtëzakonshëm turistësh shqiptarë, pra shqiptarësh të interesuar. Ai ishte një vendbanim, një vendstrehim për Shtabin e Përgjithshëm në rast lufte apo emergjence të jashtëzakonshme.

Shqipëria ka vuajtur vite nën regjimin e egër komunist dhe ka pika të tilla, si, për shembull, burgu i Spaçit apo vende famëkeqe që mund të shërbejnë edhe për një tipologji tjetër turisti si ata që kërkojnë të vizitojnë vendet ku manifestohet egër një diktaturë apo një regjim fashist, siç është rasti i kampeve të përqendrimit nëpër Europë. Pra, duke analizuar tipologjinë e shqiptarit që shkon t’i bëjë pushimet jashtë, se çfarë shërbimesh merr dhe, në rast se janë disa oferta të cilat nuk mund t’i marrë në Shqipëri, është e kotë që ta tërheqësh atë kategori turisti, por ama mund të shihet mundësia e mbajtjes në Shqipëri të atyre turistëve që kërkojnë gjëra të cilat Shqipëria mund t’ua ofrojë. E njëjta gjë vlen edhe për ata që duan ta vizitojnë Shqipërinë. Pra, çfarë karakteristikash ka Shqipëria që nuk i ka Greqia apo Italia dhe, nëse ka një interes për të

parë një vend të izoluar në diktaturë apo për të parë vendndodhje si ajo që përmenda, e burgut të Spaçit, atëherë pse të mos shihet edhe mundësia e ofertës turistike për një kategori të tillë turisti?

(Deputetja Shkja flet pa mikrofon.)

Infopoint-in e ka merak zonja Shkja, por do ta bëjmë pjesë të diskutimit të ligji. Ndaj do të doja, zoti Gaçi, që ta përfshini sa më intensivisht Esmeraldën për çështjen.

Atëherë, zoti Dalipi, na bëni një përmbledhje, sepse kishte pyetje, komente dhe sugjerime. Faleminderit!

Alfred Dalipi – Pa dyshim, çdo dëshirë për ta bërë turistike të gjithë Shqipërinë edhe për disa dhjetëvjeçarë nuk do të marrë përgjigje. Pikërisht, prandaj ne vijmë këtu për të sjellë zonat me përparësi zhvillimi të turizmit.

Duhet saktësuar se prezantimi që u bë ishte vetëm një prezantim konciz, kurse relacioni që i ka ardhur Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese është më i detajuar, ku përfshihet e gjithë metodologjia dhe të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces.

Nuk është lënë asnjë përfaqësues i pushtetit vendor pa sjellë sugjerimet e veta (relacioni këto i ka), prefekturat, qarqet, bashkitë që kanë potenciale, por edhe ato që nuk kanë, kanë prezantuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban mundësitë e tyre për t'u përfshirë në këtë studim. Pra, relacioni ka edhe emërtesat konkrete. Çfarë i mungon të gjithë studimit që kemi bërë? Pra, zonifikimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit i mungojnë vetëm koordinatat jo për të gjitha zonat që kanë marrë statusin sipas këtij studimi me përparësi zhvillim turizmi. Kjo do të thotë se nuk i ka koordinatat gjeografike të përcaktuara ngushtësisht. Për shembull, Voskopojë do të merret si Voskopojë, apo si njësi e gjerë?

Eduard Shalsi – Meqenëse jemi këtu, duke parë hartën, a mund të na shpjegoni se çfarë përfaqësojnë njollat me ngjyra të ndryshme?

Alfred Dalipi – Të gjitha ngjyrat, siç u shpjegua edhe aty, përfaqësojnë çfarëdolloj vendimmarrjeje për tipologji të ndryshme: ku është park i mbrojtur, ku është zonë e mbrojtur, ku është park kombëtar, ku është zonë arkeologjike, ku është zonë ekonomike...

Eduard Shalsi – Në rregull.

Alfred Dalipi – Pra, të gjitha ato atje përbëjnë çka quhen “zona me përparësi zhvillim turizmi” dhe Tirana është zemra e të gjithë kësaj, sepse është edhe qendër administrative, ku ka të gjitha objektet që janë elemente kur përcaktohet një zonë me përparësi të zhvillimit të turizmit,

sepse ka muzetë, është qendër administrative, ka aksin kryesor ekonomik. Pra, të gjitha këto janë të përcaktuara në relacion edhe me emërtesa konkretisht se cila është pjesë e këtij studimi. Nuk ka dyshim fare që të gjitha objektet e trashëgimisë janë të përfshira. Pra, procesi ka qenë gjithëpërfshirës edhe për pushtetin vendor, bashki, prefektura, komuna dhe qarqe.

Për sa i përket pyetjes së zotit Gaçi për strategjinë, janë katër dokumente zyrtare që do të përfshijnë të gjithë zhvillimin e industrisë së turizmit: ligji, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit 2014-2020, përcaktimi që kemi sot për zonat me përparësi dhe...

Eduard Shalsi – A është hartuar Strategjia 2014-2020, apo po hartohet?

Alfred Dalipi – Ne e kemi përfunduar dhe e kemi gati për Këshillin e Ministrave. I kemi mbaruar të gjitha debatet, të gjitha vendimmarrjet. Strategjia është një dokument që është hedhur prej dy muajsh në adresën elektronike të ministrisë, pra është dokument i miratuar nga ana jonë.

Dokumenti i katërt është Plani Kombëtar i Zhvillimit të Turizmit, që do të bëhet pasi të miratohet ligji i turizmit.

Këto të katër dokumentet...

Eduard Shalsi – Cili ishte dokumenti i tretë? E dyta ishte strategjia...

Alfred Dalipi – Përcaktimi i zonave...

Eduard Shalsi – Në rregull.

Alfred Dalipi – Janë këto të katërta: ligji, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit, që është në adresë dhe mund të konsultohet kushdo, është edhe për investorët e huaj, që të shikojnë si është parë nga qeveria shqiptare zhvillimi deri në vitin 2020, përcaktimi i zonave me përparësi dhe plani kombëtar, i cili do të vijë pasi të miratohet ligji.

Brenda kësaj Strategjie është edhe turizmi religjioz.

Një nga pyetjet tuaja, zoti kryetar, kishte të bënte me produktet e komunizmit. Drejtoresha e Përgjithshme e Turizmit pranë ministrisë mund t'i sqarojë të gjitha këto produkte me një ndërhyrje fare të thjeshtë, sepse ne e kemi paraparë si një mundësi për të sjellë turistë të cilët në vendet e rajonit nuk arrijnë ta gjejnë këtë produkt aq mirë të strukturuar sa edhe ne... Hapja e Bunk'Artit është një nga objektet që Ministria e Zhvillimit Urban ka...

Për turizmin religjioz dhe të trashëgimisë mund të flasë zonja.

Eduard Shalsi – Vetëm në mënyrë koncize, ju lutem!

Sonja Popa – Dua t’ju falënderoj të gjithëve për sugjerimet që na dhatë!

Zoti Dalipi e theksoi, janë katër dokumente dhe të gjitha këto çështje përfshihen ose në njërën, ose në tjetrin, ose në disa bashkë. Nuk diskutohet.

Për sa i përket pyetjes së fundit, për Bunk’Artin, ne kemi ngritur një grup pune bashkë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me pjesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit, e pjesëtarëve, me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për të identifikuar të gjitha ato prona që Ministria e Mbrojtjes i ka jashtë përdorimit, të cilat mund të kthehen në objekt turistik. Jemi duke punuar në këtë drejtim, por do të dojë njëfarë kohe, sepse bëhet fjalë për të gjithë Shqipërinë. Më me përparësi janë disa zona, si për shembull, e Dajçit, aeroporti i Dajçit, që mund të futet shpejt në punë e të tjera, duke përdorur edhe vetë burimet e Ministrisë së Mbrojtjes, si persona të dalë në pension e të tjerë që mund të shërbejnë dhe të tregojnë historikun e këtyre zonave. Pra, e kemi parasysh këtë gjë.

Dua të theksoj se dokumenti i sotëm nuk është vetë ligji, nuk është vetë strategjia, por të gjitha këto janë pjesë që trajtohen në strategji dhe në ligj. Ky është vetëm zonimi, sepse, pa pasur zonat e përcaktuara për zhvillimin, ne nuk mund të kemi investime në turizëm, nuk mund të kemi të identifikuar standardet në ato zona, pavarësisht nëse turistët që do të vijnë do të jenë shqiptarë, apo të huaj; është e njëjta gjë. Domethënë, patjetër që turizmi vendas është shumë i rëndësishëm dhe duhet të bëhet, por zonimi nuk ka të bëjë me llojin e turistit, shqiptar apo i huaj, apo është nga Izraeli, nga një vend tjetër, nga një vend tjetër.

Eduard Shalsi – E qartë.

Sonja Popa – Patjetër që bëhet analiza e tipologjive të turistëve të ndryshëm për të ngritur një produkt të caktuar për secilin nga këta, por kjo bëhet në strategji, jo te zonimi. Kjo është ideja.

Alfred Dalipi – Ne nuk kemi përcaktuar asnjë zonë të re, pra nuk i përcakton ministria këto zona, por vijnë për shkak të statusit që përfaqësojnë vetë zonat. Ne i marrim nga territori dhe nga të gjitha dokumentet që interferojnë.

Eduard Shalsi – Ndërkohë që nuk përjashtohet mundësia e futjes së zonave të reja, apo jo?

Alfred Dalipi – Gjithmonë, kur arrin të formatohet një produkt, siç po themi se në rastin konkret produkti i turizmit të diktaturës do të fillojë të formatohet i plotë, sepse të gjitha

këto objekte do të pasurohen edhe me objekte të tjera, qoftë edhe të banesave ku përfaqësues të nomenklaturës, repartet ushtarake apo objekte, të cilat janë përdorur në mënyrë strategjike gjatë viteve të diktaturës, të gjitha këto do të formatohen te ky dhe kështu mund të zgjerohen gjithmonë zonat.

Mund të ketë edhe parqe apo resorte të cilat mund të jenë investime të reja, rishtazi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të jenë te fotot.

Eduard Shalsi – Edhe në emër të komisionit, do të desha t’ju falënderoja sinqerisht për punën dhe ju inkurajojmë të vijoni në këtë drejtim!

Mirupafshim dhe mirutakofshim në takime të tjera!

Shumë faleminderit dhe punë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET